

Vendim nr. 26 datë 16.05.2023

(V-26/23)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 16.05.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 14 (E) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **BEJAZE VEIZAJ, TEFTA VEIZAJ, ESAT VEIZAJ**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

**VALTER VEIZAJ, MIRKA VEIZAJ, VIOLETA VEIZAJ,
PAJTIM VEIZAJ, ASTRIT VEIZAJ, AGJENCIA
SHTETËRORE E KADASTRËS, DREJTORIA VENDORE,
VLORE**

OBJEKTI: **Ndreqje gabimi në vendimin nr. 31, datë 03.11.2022 të Gjykatës
Kushtetuese.**

BAZA LIGJORE: Neni 80 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën e kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Valter Veizaj dhe Mirka Veizaj, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të tjera të interesuara, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasit Bejaze Veizaj, Tefta Veizaj dhe Esat Veizaj, me kërkesën e datës 18.02.2022, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimeve nr. 752, datë 29.03.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nr. 1158, datë 21.10.2015 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr. 00-2021-1694, datë 18.10.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

2. Gjykata, me vendimin nr. 31, datë 03.11.2022, ka vendosur: *“1. Pranimin pjesërisht të kërkesës. 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 1158, datë 21.10.2015 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimit nr. 00-2021-1694, datë 18.10.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. 3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë.”*

3. Pas publikimit të vendimit të Gjykatës, në datën 09.12.2022 njëri nga kërkuesit në atë gjykim kushtetues, Esat Veizaj, ka paraqitur kërkesë për saktësimin e vendimit, konkretisht për ndreqjen e paragrafit 1 të vendimit nr. 31, datë 03.11.2022, sipas të cilit: *“1. Kërkuesit Bejaze Veizaj, Tefta Veizaj dhe Esat Veizaj janë trashëgimtarë të shtetasit H. V. (gjyshi i tyre), 3 fëmijët e të cilit (baballarë të paditësve dhe të paditurve në procesin gjyqësor të kundërshtuar), pasi ai ka ndërruar jetë, kanë ndarë në tri pjesë, secila me hyrje më vete, pasurinë e paluajtshme banesë dykatëshe, e ndodhur në lagjen “Partizani” në qytetin e Vlorës, të regjistruar në emër të djalit Z.V.”*.

4. Sipas kërkuesit, në këtë paragraf ka pasaktësi, sepse kërkuesit janë trashëgimtarë të shtetasit Z.V dhe jo të shtetasit H.V. Bejaze Veizaj në të vërtetë është bashkëshortja e shtetasit Z.V., ndërsa Tefta dhe Esat Veizaj janë fëmijët e Bejaze Veizajt dhe të shtetasit Z.V. Ky i fundit është trashëgimtar ligjor i shtetasit H.V., ndërsa pasuria, sipas ligjit të kohës, është pasuri bashkëshortore e Bejaze Veizaj dhe Z.V., e fituar gjatë martesës.

5. Me vendimin e datës 27.01.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në datën 07.04.2023 të tre kërkuesit kanë saktësuar se ndreqjen e gabimit në vendimin nr. 31, datë 03.11.2022 e kanë kërkuar shtetasit Bejaze Veizaj, Tefta Veizaj dhe Esat Veizaj (pala kërkuese në këtë vendim).

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. **Kërkuesit** kanë pretenduar se paragrafi nr. 1 i vendimit nr. 31, datë 03.11.2022 ka pasaktësi, sepse kërkuesit janë trashëgimtarë të shtetasit Z.V. dhe jo të shtetasit H.V., ndërsa pasuria e paluajtshme, sipas ligjit të kohës, është pasuri bashkëshortore e fituar gjatë martesës midis shtetasve Z.V. dhe Bejaze Veizaj. Sipas tyre, subjektet e interesuara në atë gjykim kanë paraqitur dokumente të falsifikuara, duke shtrembëruar faktet dhe rrethanat e çështjes.

7. **Subjektet e interesuara, Valter Veizaj dhe Mrika Veizaj**, kanë prapësuar se kërkesa është abuzive, pasi vendimi nr. 31, datë 03.11.2022 nuk ka gabime në shkrim, është i qartë dhe lehtësisht i kuptueshëm.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

8. Në rastet kur Gjykata vihet në lëvizje për ndreqjen e gabimit në vendimin e saj, legjitimimi i kërkuesit dhe procedura parashikohen në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000. Sipas kësaj dispozite, Gjykata ka të drejtë, me kërkesë, të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në vendim, pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit. Vendimi i Gjykatës në këto raste publikohet në Fletoren Zyrtare. I njëjti rregull parashikohet edhe në nenin 43 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit kur kërkesa ka të bëjë me një vendim përfundimtar, kompetente për shqyrtimin e saj është Gjykata.

9. Në këto kushte, Gjykata, pasi administroi vendimin e saj nr. 31, datë 03.11.2022, konstaton se kërkuesit, si palë pjesëmarrëse në gjykimin e mëparshëm që është përmbyllur me vendimin që kërkohet të ndreqet, plotësojnë kriterin për legjitimimin *ratione personae* të tyre. Po ashtu, vërehet se ata i janë drejtuar Gjykatës në datën 09.12.2022, ndërsa vendimi objekt kërkesë është dhënë nga kjo Gjykatë në datën 03.11.2022. Për rrjedhojë, kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-mujor të parashikuar në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000.

10. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, në kuptim të kompetencës lëndore të Gjykatës, vihet re se kërkuesit në kërkesën e tyre kanë pretenduar ndreqjen e gabimit të vendimit nr. 31, datë 03.11.2022, pasi në paragrafin 1 të tij ka pasaktësi si në lidhje me trashëgimtarët e shtetasit Z.V., ashtu edhe me pronësinë e pasurisë së paluajtshme.

11. Gjykata vëren se me vendimin nr. 31, datë 03.11.2022 është vendosur kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë, për shkak se u konstatua cenimi i së drejtës së aksesit të kërkuesve në atë gjykatë. Në paragrafin 1 të vendimit të lartpërmendur është bërë një gabim

material në lidhje me faktin se shtetasja Bejaze Veizaj nuk është trashëgimtare e shtetasit H.V., por e bashkëshortit të saj Z.V., i cili është djali i H.V., kurse Esat dhe Tefta Veizaj janë fëmijët e Bejaze Veizaj dhe Z.V. Gjykata konstaton se faktet në lidhje me të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme janë objekt i gjykimit që po zhvillohet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe sipas materialeve të depozituara në gjykimin kushtetues, konkretisht notës së transkriptimit 11, volumni XVII, viti 1953, në emër të Z.V. rezulton e regjistruar pasuria e paluajtshme banesë dykatëshe, e ndodhur në lagjen “Partizani” në qytetin e Vlorës.

12. Për sa më lart, duke qenë se përmbajtja e vendimit nr. 31, datë 03.11.2022 ka një gabim material në lidhje me trashëgimtarët e H.V., dhe ndreqja e tij nuk ndryshon thelbin e vendimmarrjes, Gjykata vlerëson se kërkimi për saktësimin e këtij vendimi duhet të pranohet. Ndërsa për sa i përket pretendimit tjetër të kërkuesve që ka të bëjë me pasurinë e paluajtshme, objekt i konfliktit gjyqësor, ai do t’i nënshtrohet vlerësimit të gjykatave të zakonshme gjatë rishqyrtimit të çështjes, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

13. Si përfundim, paragrafi 1 i vendimit nr. 31, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese, bëhet: *“Kërkuesit janë trashëgimtarë ligjorë të Z.V., ky i fundit djali i H.V. Në emër të Z.V. rezulton e regjistruar pasuria e paluajtshme banesë dykatëshe, e ndodhur në lagjen “Partizani” në qytetin e Vlorës.”*.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Saktësimin e paragrafit 1 të vendimit nr. 31, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese, i cili bëhet si vijon: *“Kërkuesit janë trashëgimtarë ligjorë të Z.V., ky i fundit djali i H.V. Në emër të Z.V. rezulton e regjistruar pasuria e paluajtshme banesë dykatëshe, e ndodhur në lagjen “Partizani” në qytetin e Vlorës.”*.
2. Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit përfundimtar nr. 31, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.05.2023

Shpallur më 15.06.2023